



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë – E Mërkurë, 8 Tetor 2014

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 501, datë 30.7.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 965, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të pronës me nr. 37, me emërtimin “Ministria e Mbrojtjes”, me vendndodhje në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar	7975
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 627, datë 24.9.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil””, të ndryshuar.....	7976
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 642, datë 1.10.2014	Për shfuqizimin e vendimit nr. 354, datë 4.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e bazës së të dhënave IMEI dhe regjistrimin e numrave IMEI të aparateve celulare, që përdoren në rrytet e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme”	7976
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 646, datë 1.10.2014	Për kalimin e pronës së paluajtshme shtetërore, me emërtimin “Ish-Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë”, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 834, datë 13.12.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Tiranë, të qarkut të Tiranës”, si dhe për një shtesë në vendimin nr. 1292, datë 24.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të trojeve dhe ndërtesave të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të gjykatave të apelit”, të ndryshuar.....	7977



VENDIM

Nr. 501, datë 30.7.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 965, DATË 25.10.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTERIA E MBROJTJES TE MINISTERIA E FINANCAVE DHE MINISTERIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, TË PRONËS ME NR. 37, ME EMËRTIMIN “MINISTERIA E MBROJTJES”, ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN “DËSHMORËT E KOMBIT”, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTERISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën “b”, të pikës 1, të vendimit nr. 965, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave, të shtohet shkronja “b/1”, me këtë përmbajtje:

“b/1) Nga sipërfaqja e përgjithshme, kaluar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, objekti me sipërfaqe 673 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre) m², pjesë e pronës me nr. 37, me vendndodhje në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, të kalojë në përgjegjësi administrimi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi, për t’u përdorur si mjedise pune nga ky institucion.”

2. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.


3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANVENDOSJA E PRONËS NR. 37

Sipërfaqja e objektit që kërkohet për kalim kapital nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS) Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)



**VENDIM**

Nr. 627, datë 24.9.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 116, DATË 5.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR STATUSIN E NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE AKTUALE QË PËRFITOJNË STATUSIN E NËPUNËSIT CIVIL SIPAS LIGJIT NR. 152/2013, “PËR NËPUNËSIN CIVIL””, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 67, pika 8 e 69, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e kreut IV të vendimit nr. 116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Në rast se për shkaqe të arsyeshme procedura nuk ka përfunduar brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të kreut IV të këtij vendimi, DAP-i/njësia përgjegjëse ka të drejtën e shtyrjes së afatit një herë të vetme. Në çdo rast, shtyrja e afatit nuk mund të jetë më vonë se data 30 tetor 2014.

Përfundimisht për nëpunësit/punonjësit civilë në strukturat e Forcave të Armatosura apo institucionet e tjera të varësisë, pjesë të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, afati i deklarimit të statusit të punësimit përfundon në datën 31 dhjetor 2014.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 642, datë 1.10.2014

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 354, DATË 4.6.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGRITJEN E BAZËS SË TË DHËNAVE IMEI DHE REGJISTRIMIN E NUMRAVE IMEI TË APARATEVE CELULARE, QË PËRDOREN NË RRJETET E SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE TË LËVIZSHME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 dhe 124, të ligjit nr. 8485, datë 2.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit nr. 354, datë 4.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e bazës së të dhënave IMEI dhe regjistrimin e numrave IMEI të aparateve celulare, që përdoren në rrjetet e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM

Nr. 646, datë 1.10.2014

**PËR KALIMIN E PRONËS SË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, ME
EMËRTIMIN “ISH-DREJTORIA E
KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË
MESME, TIRANË”, NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
DREJTËSISË, DHE PËR NJË NDRYSHIM
NË VENDIMIN NR. 834, DATË 13.12.2006,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË PJESSHME TË
INVENTARIT (PJESA E PARË + PJESA E
DYTË) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË BASHKINË TIRANË,
TË QARKUT TË TIRANËS”, SI DHE PËR
NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1292,
DATË 24.9.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË
MINISTRISË SË DREJTËSISË TË
TROJEVE DHE NDËRTESAVE TË
GJYKATAVE TË RRETHEVE
GJYQËSORE DHE TË GJYKATAVE TË
APELIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 12, 13, 14 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e pronës së paluajtshme shtetërore, me emërtimin “Ish-Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë”, ndodhur në zonën kadastrale 8160, me numër pasurie 2/82, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, në funksion të akomodimit të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.

2. Heqjen e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 834, datë 13.12.2006, të Këshillit të Ministrave, dhe shtimin e kësaj prone në listën e inventarit të pronave shtetërore miratuar me vendimin nr. 1292, datë 24.9.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ministria e Drejtësisë nuk mund ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Drejtësisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja “Kristalina”
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 8 lekë